

EDMOND ÇALI

**NDIHMESA E CARLO TAGLIAVINI-T, FRANCESCO ERCOLE-S
DHE GIUSEPPE SCHIRÒ-IT PËR REVISTËN “RIVISTA
D’ALBANIA” SIPAS LETËRKËMBIMIT TË TYRE**

Materiali për të cilin diskutojmë sot këtu ndodhet në Arkivin e bibliotekës “Biblioteca dell’Accademia Nazionale dei Lincei e Corsiniana”, Via della Lungara, 10 në Romë. Dosja 242, e fondit “Reale Accademia d’Italia. Centro Studi Albania”, përmban korrespondencën midis Francesco Ercole-s (1884-1945), Giuseppe Schirò-it (1905-1985) dhe gjuhëtarit italian Carlo Tagliavini (1903-1982). (Dosja “Reale Accademia d’Italia. Centro Studi Albania. Tagliavini” në kapakun e saj ka edhe adresën e Prof. Tagliavini-t: Prof. Carlo Tagliavini / Via Baraccano, 5 / Bologna. Emërtimi i pakos ku gjendet dosja 242 është: CA B14 fasc 242). Janë 69 letra, kartolina dhe telegrame. Letrat e Tagliavini-t janë ato që kanë mbërritur në Qendrën e Studimeve për Shqipërinë. Në dosje kemi edhe kopjet e protokolluara të letrave që Prof. Tagliavini-t i kanë dërguar Schirò-i dhe Ercole¹. Materiali na ndihmon të njohim veprimtarinë e Qendrës, rolin e Tagliavini-t, Ercole-s dhe Schirò-it gjatë periudhës së botimit të revistës “Rivista d’Albania” në botimin e revistës, marrëdhëniet midis tyre, rolin e tyre në botimet e tjera të Qendrës. Materiali na informon edhe për veprimtarinë e Prof. Eqrem Çabejit në lidhje me Atlasin Gjuhësor Shqiptar.

Letërkëmbimi fillon me letrën që Francesco Ercole i dërgon Carlo Tagliavini-t më datë 17 shkurt 1940. Ercole lajmëron Tagliavini-n se Qendra e Studimeve për Shqipërinë do të fillojë botimin e revistës “Rivista d’Albania”. Informohemi se për këtë fakt Ercole i ka shkruar edhe më datë 1 shkurt Tagliavini-t. Menjëherë kemi temat që do të hasim në shumë prej letrave: bashkëpunimin e Tagliavini-t me artikuj shkencorë si edhe me

¹ Për botimin e plotë shiko: *Letërkëmbim (1940 – 1943). Carlo Tagliavini - Giuseppe Schirò - Francesco Ercole*, Përgatitur për botim nga Bejtullah Destani dhe Edmond Çali, Përktheu nga italishtja dhe pajisi me shënime Edmond Çali, “Hyrje” nga Edmond Çali, Libritalia, 2016, ff. 206.

përgatitjen e rubrikës “Pasqyra gjuhësore” të revistës “Rivista d’Albania” mbi studimet gjuhësore në fushë të shqipes.

Numri i parë i revistës “Rivista d’Albania” del në prill 1940. Në ballinën e revistës shikojmë se revista drejtohet nga Francesco Ercole, se është organ i “Centro di Studi per l’Albania” – “Qendrës së Studimeve për Shqipërinë” të “Reale Accademia d’Italia” – “Akademisë Mbretërore të Italisë”. Shikojmë se revista botohet nga “Istituto per gli studi di politica internazionale Milano” – “Instituti për studimet e politikës ndërkombëtare Milano”. Në brendi të revistës gjejmë menjëherë emrat e anëtarëve të Këshillit të Qendrës së Studimeve për Shqipërinë (“Consiglio del Centro di Studi per l’Albania”).

Lista e plotë jepet në numrin e parë të revistës (fascicolo I, Aprile 1940); kujtojmë vetëm disa emra (nga 19 që janë gjithsej):

Federzoni Luigi – Kryetar

Ercole Francesco – Drejtor

Anëtarë:

Cordignano Fulvio – misionar jezuit

Fishta Giorgio – Akademik i Italisë.

Rikthehemi te letra e parë. Ercole ndodhet në Romë dhe i shkruan Tagliavini-t që punon në Padova. Në fillim i kujton se do të fillojë botimi i revistës:

“Come avete saputo dalla lettera inviataVi il 1 febbraio, questo Centro di Studi inizierà prossimamente la pubblicazione della “Rivista d’Albania”².

Pastaj menjëherë kalon në propozimin konkret:

“Sarei molto lieto se, oltre a scrivere degli articoli, assumeste la collaborazione per la rassegna degli studi di glottologia albanese. La Vostra competenza in merito concorrerà a dare alla Rivista quell’importanza che io intendo conferirle”³.

Madje kemi referimin për punimin e parë të Tagliavini-t që del në *Rivista d’Albania*:

“Mentre Vi ringrazio anticipatamente della Vostra collaborazione, Vi prego di volermi dare in merito un segno di riscontro, e di volermi dire se

² “Siç e mësuat nga letra që Ju dërgova më 1 shkurt, kjo Qendër Studimesh do të fillojë së afërmi botimin e revistës ‘Rivista d’Albania’”, Ercole a Tagliavini, 17 febbraio 1940.

³ “Do të isha i lumtur nëse, përveçse të shkruanit artikuj, të merrnit bashkëpunimin për pasqyrën mbi studimet e glotologjisë shqiptare. Kompetenca Juaj për këtë temë do të ndihmojë për t’i dhënë revistës atë rëndësi që unë dua t’i jap”, po aty.

avete in proposito di mandare un Vostro articolo da pubblicare nei primissimi numeri del periodico"⁴.

Që në këtë letër hasim disa nga temat që na interesojnë edhe në pjesën tjetër të korrespondencës: daljen e numrave të revistës, shkrimet-artikujt që boton Tagliavini në revistë dhe rubrikën e pasqyrës gjuhësore të revistës që Tagliavini merr përsipër të përgatisë.

Përsa i përket pasqyrës gjuhësore, më saktë pasqyrës bibliografike të gjuhësisë, citojmë një sygjërim shumë domethënës të vetë Ercole-s për Tagliavini-n:

"Caro Tagliavini,

ho avuto la rassegna di linguistica per il prossimo numero della rivista, che ho già mandato in tipografia, e ti ringrazio di cuore della tua solerte e preziosa collaborazione.

Considero però necessario che io ti esponga alcune mie idee sul tono della rassegna. Esse debbono avere il duplice scopo: 1° di informare gli autori delle produzioni più recenti nei vari settori dell'albanologia, 2° di dare agli studiosi la soddisfazione che i loro studi vengono citati nella rivista della Reale Accademia d'Italia per trarre, da questo fatto, incoraggiamento a continuare a produrre per il progresso della disciplina che ciascuno coltiva"⁵.

Dhe vijon, sipas nesh, pjesa më e rëndësishme e shkrimit:

"Tu, sei sen [z]'altro d'accordo con me nel considerare necessario che lo studioso, nel vedere recensito il proprio lavoro, riscontri, fin dove è possibile, la considerazione dei propri sforzi e i consigli espressi in tono cordiale per indurlo a progredire e per eliminare nell'avvenire gli

⁴ "Duke Ju falënderuar paraprakisht për bashkëpunimin Tuaj, Ju lutem që të më jepni për këtë gjë një përgjigje, dhe të më thoni nëse keni ndër mend që të dërgoni një artikull Tuajin për t'u botuar në numrat e parë të periodikut", *po aty*.

⁵ "I dashur Tagliavini,

Mora pasqyrën gjuhësore për numrin e ardhshëm të Revistës, të cilën tashmë e dërgova në tipografi, dhe të falënderoj nga zemra për bashkëpunimin tënd të shpejtë dhe të çmuar.

Por e quaj të nevojshme që unë të të parashtoj disa ide të miat për tonin e pasqyrës. Ato duhet të kenë dy qëllime: 1° të informojnë autorët për prodhimet më të fundit në sektorët e ndryshëm të albanologjisë, 2° t'u japin studiuesve kënaqësinë që studimet e tyre citohen në revistën e Akademisë Mbretërore të Italisë për të nxjerrë, nga ky fakt, inkurajim për të vazhduar të prodhojnë për përparimin e disiplinës me të cilën merret secili prej tyre", Ercole a Tagliavini, 8 settembre 1941.

*eventuali errori in cui egli sia caduto. È evidente che nessuno meglio di te, potrebbe apportare nel campo della linguistica una così ampia e preziosa collaborazione. Però mi sembra che la tua tendenza che spesso si nota nei tuoi giudizi, quale risulta dalle tue rassegne, a calcare la penna dove riscontri un errore o sviste, in cui è fatale che incorra chiunque dedichi se stesso alla scienza ed alla cultura, non sia forse e sempre la più adatta a incoraggiare lo studioso*⁶.

Mbërrijmë kështu tek shembulli i Abedin Fezicit. (Për këtë shiko edhe Mimoza Prikun, “Punimet bibliografike të K. Tagliavinit në *Rivista d’Albania*”, në *Carlo Tagliavini dhe studimet abanologjike rreth shqipësisë*, botimet Camaj – Pipa, 2011, ff. 203-219, ff. 211-212). Le ta shohim se çfarë shkruan Tagliavini në revistë në pasqyrën e tij gjuhësore dhe se çfarë shkruan Ercole në letrën e tij.

Ercole shkruan: *“La grammatica di Abedin Feizi e il manuale di conversazione dello stesso autore, contengono invero, come dice anche Schirò, svariati errori, dovuti in parte ad una trascurata edizione e in parte a una incostante linea di condotta ed anche faciloneria però dire che l’Abedin deve lasciare l’albanese e dedicarsi al turco mi sembra un po’ troppo. Simile consiglio corrisponde ad un invito al Direttore dell’Istituto Orientale di Napoli, perché dia all’Abedin l’ostracismo dalla cattedra di lingua labanese [albanese]. Invece noi dobbiamo soltanto giudicare il lavoro e non ingerirci nelle attività professionali dello studioso. Perfino nella rassegna del lavoro del Bartoli non manca qualche puntata che può urtare la sua suscettibilità, la quale come sai non è poca, per esempio la frase: “Il Bartoli che è informatissimo non conosce la tale opera”. Ho citato questi due casi a mo’ di esempio”*⁷.

⁶ “Ti, patjetër je i një mendjeje me mua, se duhet ta konsiderojmë të nevojshme që studiuesi, kur ta shohë recensionin e punimit të tij, të hasë, deri ku është e mundur, marrjen në konsideratë të përpjekjeve të veta dhe këshillat e shprehura në ton të përzemërt për ta nxitur që të përparojë dhe për të shmangur në të ardhshmen gabimet e mundshme në të cilat mund të ketë rënë. Është e qartë se asnjë tjetër më mirë se sa ti, nuk do të mund të sjellë në fushën e gjuhësisë një bashkëpunim kaq të gjerë dhe kaq të çmuar. Por më duket se prirja jote që shpesh vihet re në gjykimet e tua, siç rezulton nga pasqyrat e tua, për të vënë në pah me forcë gabimet dhe pakujdesitë, me të cilat është fatale që të përballet cilido që ia kushton veten e tij shkencës dhe kulturës, të mos jetë ndoshta gjithmonë më e përshtatshme për ta inkurajuar studiuesin”, po aty.

⁷ “Gramatika e Abedin Fezicit dhe doracakut e bisedave të njëjtë autor, me të vërtetë kanë, ashtu siç thotë edhe Schirò-i, shumë gabime, që i detyrohen

Nuk jemi në gjendje të caktojmë nëse letra është shkruar e dërguar para apo pas botimit të revistës: letra është e datës 8 shtator 1941, kurse numri i revistës është ai i muajit shtator të vitit 1941. Sidoqoftë fjalinë e Ercole-s “*l’Abedin deve lasciare l’albanese e dedicarsi al turco*” nuk e gjejmë në shkrimin e botuar në revistë. (Shiko pjesët “Morfologia – Abidin Feizi, Grammatica albanese” dhe “Lessico. Abidin Feizi, Manuale di conversazione italo-albanese” në Carlo Tagliavini, “Rassegne bibliografiche, Linguistica II”, në *Rivista d’Albania*, Anno II, Fasc. III, settembre 1941, ff. 277-285, për Veizin ff. 280-283, dhe për Bartoli-n, *po aty*, ff. 277-279).

pjesërisht një botimi të pakujdesshëm, dhe pjesërisht mungesës së një linje veprimi si edhe trajtimi sipërfaqësor, por të thuash që Abedini duhet ta lërë shqipen dhe t’i kushtohet turqishtes më duket pak tepër. Një këshillë e ngjashme duket si një ftesë për Drejtorin e Institutit Oriental të Napolit, që t’i krijojë Abedinit pengesa për katedrën e gjuhës shqipe. Kurse ne duhet të gjykojmë vetëm punën dhe jo të përzihemi në veprimtaritë profesionale të studiuesit. Madje edhe në pasqyrën e punimit të Bartoli-t, nuk mungon ndonjë kritikë që mund të prekë ndjeshmërinë e tij, e cila siç e di nuk është e pakët, për shembull fjalia: “Bartoli që është shumë i informuar nuk e njeh këtë vepër”.

Citova këto dy raste si shembuj”, *po aty*. Ja dhe vazhdimi i letrës: “*Ti sarò in ogni modo grato se tenendo conto di quanto ti ho scritto, vorrai tu stesso apportare sulle bozze, in questo ed in altri punti, quelle modifiche formali che giudicherai opportune per togliere qualsiasi impressione che nelle nostre rassegne si tenda più a cercare i difetti che i pregi di chi occupandosi dei nostri studi, sia eventualmente incorso in qualche errore, o di chi s’ispiri a criteri scientifici non condivisi dalla maggioranza degli studiosi.*

Sono certo che tu sei il primo a renderti conto dei motivi che mi hanno mosso a scriverti, e ringraziandoti di cuore, ti saluto affettuosamente.

(*Francesco Ercole*).” (“Sidoqoftë do të ta di për nder në qoftë se duke pasur parasysh sa të shkrova, vetë ti do të bësh tek bocat, te kjo pikë dhe në pika të tjera, ato ndryshime formale që do t’i gjykoshe me vend për të hequr çfarëdolloj përshtypjeje se në pasqyrat tona ka prirje më shumë për të kërkuar të metat se sa vlerat e atij, që duke u marrë me studimet tona, të ketë bërë ndonjë gabim, ose të atij që frymëzohet nga kritere shkencore me të cilat nuk është në një mendje pjesa më e madhe e studiuesve. Jam i sigurt se ti je i pari që i ke kuptuar shkaqet që më bënë të të shkruaj, dhe duke të falënderuar nga zemra, të përshëndes me dashuri.” (Francesco Ercole)). Letra që e cituam të plotë është një letër e Francesco Ercole-s për Carlo Tagliavini-n e datës 8 shtator 1941. Janë dy faqe të shkruara me makinë shkrimi. Në faqen e parë lart, djathtas është shkruar data: “*Roma 8 settembre 1941 / XIX*”. Poshtë datës është shkruar me dorë numri i protokollit: 1255.

Po ashtu edhe fjalia e cituar nga Ercole: *“Il Bartoli che è informatissimo non conosce la tale opera”* nuk gjendet në shkrimin për Bartoli-n. Kjo gjë na lë të kuptojmë se ndoshta ndonjë ëmbëlsim të tonit të thartë të Tagliavini-t revista e bënte dhe e arrinte, me udhëzim të Ercole-s, nëpërmjet korigjimit nga ana e vetë autorit siç na sqaron edhe letra e Schirò-it për Tagliavini-n e datës 9 shtator 1941.

Ka rëndësi kjo temë, pra, edhe sepse për këtë gjë Tagliavini-t i shkruan edhe Schirò-i. Letra e Schirò-it është një përmbledhje me shumë takt e sugjerimeve ëmbëlsuese të Ercole-s, për të arritur në zbutjen e ndonjë fjalie:

“Ebbi a suo tempo la rassegna linguistica che è stata poi spedita in tipografia.

In merito a qualche puntata un po' troppo pungente, l'Ecc. Ercole vi scriverà pregandovi di attenuare qualche frase”⁸.

Korrespondenca na jep edhe një pjesë të panoramës së marrëdhënieve të këtyre tri personaliteteve midis tyre, edhe pse vetëm në një kohë të caktuar. Lidhjet janë aq të forta saqë shkruhet edhe për gjëra personale: veçojmë këtu ndihmën që Tagliavini kërkon që t'i gjejnë një mësues latinishteje për një të afërme të tij⁹ ose kërkon ndihmë për tërheqjen e një pakoje me shumë vlerë që i mbërrin në Romë nga Rumania¹⁰.

Vëmë re edhe se Ercole dhe Schirò-i komunikojnë midis tyre më parë për çështjet për të cilat i shkruajnë Tagliavini-t. Dhe me korrektësi këtë gjë ia bëjnë që ta kuptojë edhe vetë Tagliavini.

Në letrat gjejmë të trajtuara edhe çështje private siç janë udhëtimet, takimet dhe çështjet financiare, p. sh. pagesa për abonënë e trenit të Profesor Tagliavini-t.

Revista “Rivista d’Albania doli me katër numra në vitin 1940, me katër numra në vitin 1941, me katër numra në vitin 1942, me katër numra në vitin 1943 dhe kemi vetëm një numër në vitin 1944. Letërkëmbimi midis tre autorëve tanë ka të bëjë me revistat duke filluar nga numri i parë e deri në korrik të vitit 1943, dmth para dy numrave të fundit të vitit 1943,

⁸ “Kur ishte gati, pashë pasqyrën gjuhësore që pastaj u dërgua në tipografi. Në lidhje me ndonjë dalje kritike pak si shumë therëse, Shkëlqesia Ercole do t’ju shkruajë duke ju lutur që të zbusni ndonjë fjali”, Schirò a Tagliavini, 9 settembre 1941.

⁹ Tagliavini a Schirò, 6 ottobre 1942.

¹⁰ Tagliavini a Schirò, 28.X.40.

Ndihmesa e Carlo Tagliavini-t, Francesco Ercole-s dhe Giuseppe...

atë të muajit shtator dhe atë të muajit dhjetor të vitit 1943, dhe para numrit të vetëm të vitit 1944, të muajt mars 1944.

Tagliavini ka botuar këto ndihmesa:

a.dy artikuj:

1) artikullin “Alcune considerazioni sulle origini e lo sviluppo della letteratura albanese”, në *Rivista d’Albania*, Fascicolo I, Aprile, 1940, ff. 71-76;

2) artikullin “Un’operetta sconosciuta della letteratura calabro-albanese”, në *Rivista d’Albania*, Fascicolo III, Settembre 1940, ff. 268-278;

b. si edhe pasqyrën gjuhësore në shtatë numra të revistës:

1) “Rassegne bibliografiche, Linguistica”, në *Rivista d’Albania*, Fascicolo II, Luglio 1940, ff. 198-208.

2) “Rassegne bibliografiche, Linguistica (1937-1939) II” në *Rivista d’Albania*, Fascicolo IV, Dicembre 1940, ff. 416-424. Është pjesa e dytë e pasqyrës së botuar në numrin e korrikut 1940. Lexojmë në shënimin në fund të faqes 416: “*La prima parte di questa rassegna è stata pubblicata alle pagg. 198-208 del fasc. II, 1940-XVIII*” (“Pjesa e parë e kësaj pasqyre është botuar në ff. 198-208 të numrit II, 1940”). Në f. 208 të numrit të korrikut 1940, në fakt, në fund të punimit, në kllapa, sqarohej: “*Le sezioni relative alla Dialettologia, Rapporti con le altre lingue balcaniche si pubblicheranno nel prossimo numero*” (“Pjesa që ka të bëjë me dialektologjinë, Marrëdhëniet me gjuhët e tjera ballkanike do të botohen në numrin ardhshëm”). Por siç e shohim botimi është bërë një numër më vonë.

3) “Rassegne bibliografiche, Linguistica”, në *Rivista d’Albania*, Anno II, Fascicolo II, Giugno 1941, ff. 181-190. Në fund të f. 190 sqarohet në kllapa: “*continua*” – “vazhdon”.

4) “Rassegne bibliografiche, Linguistica”, në *Rivista d’Albania*, Anno II, Fascicolo III, Settembre 1941, ff. 277-285.

5) “Rassegne bibliografiche, Linguistica III”, në *Rivista d’Albania*, Anno II, Fascicolo IV, Dicembre 1941, ff. 397- 413. Në f. 397, në shënimin në fund të faqes sqarohet: “*V. la prima parte in questa Rivista, II (1941) pagg. 181-190, e la parte II, ibidem, pagg. 277-285*”. (“Shiko pjesën e parë në këtë Revistë, II (1941), ff. 181-190, dhe pjesën II, ibidem, ff. 277-285”).

6) “Rassegne, Linguistica”, në *Rivista d’Albania*, Anno III, Fascicolo IV, Dicembre 1942, ff. 252-262.

7) “Rassegne, Linguistica”, në *Rivista d’Albania*, Anno IV, Fascicolo II, Giugno 1943, ff. 115-122. f. 23.

Letërkëmbimi shkon nga fillimi (shkurti) i vitit 1940 deri në (15) korrik 1943. Janë telegrame, kartolina postare dhe letra. Bëhet fjalë për korrespondencën e Prof. Carlo Tagliavini-t me Qendrën e Studimeve për Shqipërinë në Romë. Prof. Carlo Tagliavini shkruan nga Bologna ose nga Padova. Letrat e tij janë letrat që kanë mbërritur në Romë: janë letra të shkruara me dorë, letra të shkruara me makinë shkrimi dhe të firmosura prej tij dhe telegrame.

Kurse nga Roma Tagliavini-t i shkruajnë Giuseppe Schirò-i dhe Francesco Ercole. Këta të dy i nisin profesor Tagliavini-t letra ose telegrame. Kemi konsultuar kopjet e protokolluara të letrave që i kanë shkruar dhe dërguar profesor Tagliavini-t.

Materiali kap një periudhë të gjatë kohe. Shumica e fletëve të materialit është e pajisur me numër protokoli.

Temat që na interesojnë kanë të bëjnë me materialet që botohen në atë kohë ose që përgatiten të botohen nga Qendra e Studimeve për Shqipërinë.

- Bëhet fjalë për numrat e revistës “Rivista d’Albania” për të cilën Prof. Carlo Tagliavini shkruan dhe përgatit pasqyrën e botimeve për gjuhësinë,

- për artikujt e Tagliavini-t në këtë revistë,
- për pasqyrën gjuhësore të Tagliavini-t në këtë revistë,
- bëhet fjalë për dy vëllime për Kosovën dhe për Çamërinë,

Kujtojmë, me sa na rezulton, se vëllimi për Çamërinë nuk do të botohet gjatë kohës së letrave për të cilat po flasim sot. Vëllimi për Kosovën është libri “Le terre albanesi redente. I. Kossovo”, Reale Accademia d’Italia, Centro Studi per l’Albania, Roma, 1942. Në këtë vëllim, me parathënie të Ercole-s, Tagliavini do të botojë “Le parlate albanesi di tipo Ghego-orientale (Dardania e Macedonia nord-occidentale)”.

- bëhet fjalë për pyetëtorin për Atlasin Gjuhësor Shqiptar,
- për veprimtarinë e E. Çabejit për Atlasin Gjuhësor,
- bëhet fjalë për takimet dhe mbledhjet e Komitetit,
- bëhet fjalë për çështje teknike dhe burokratike: abone treni, rimbursim shpenzimesh udhëtimi,
- për çështje private.

Si përmbledhje:

Ercole shkruan 23 herë, pra janë 23 letra:

22 prej tyre i drejtohen Tagliavini-t;

Ndihmesa e Carlo Tagliavini-t, Francesco Ercole-s dhe Giuseppe...

1 prej tyre, ajo e 15 korrikut 1943 i drejtohet shefit të zyrës së administratës;

për 3 prej tyre nuk jemi të sigurt, sepse për letrën e datës 26 shkurt 1941, nuk e kemi emrin e Ercole-s në fund të letrës;

letra e datës 14 mars 1941 ka në fund emrin Giuseppe Ercole, për të cilën mund të bëjmë vetëm hipoteza; përmbajta e letrës na garanton që ajo nuk është shkruar nga Ercole, sepse në të kemi referim për Ercole-n, flitet për të; mund të ketë qenë një gabim në protokoll, ku të jetë vendosur emri i Schirò-it dhe mbiemri i Ercole-s,

dhe letra e datës 13 maj 1941, ku mungon emri i dërguesit, sipas mendimi tonë është Ercole që shkruan.

Giuseppe Schirò shkruan 26 letra.

Carlo Tagliavini shkruan 16 letra, 12 Schirò-it dhe 4 Ercolè-s.

Kemi edhe 3 letra pa emër drejtuar Tagliavini-t:

njëra është datës 16 nëntor 1942, pa emër, por ka shumë mundësi të jetë e Schirò-it, pas analizës që i kemi bërë;

njëra është e datës 11 janar 1943, pa emrin e dërguesit, por pas analizës së letërkëmbimit na del të jetë e Schirò-it;

njëra është e datës 23 janar 1943, pa emrin e dërguesit, sipas nesh kjo është letër e Ercole-s.

një letër: letra e datës 9 nëntor 1942, është një letër e Giovanni Bardi-t, titullar i tipografisë së Romës ku shtypet në atë kohë revista, drejtuar Schirò-it ose Ercole-s.

Në vijim japim tekstin e plotë të transkriptuar në italishte dhe përkthimin në shqip dy letrave. Në transkriptim kemi ruajtur ndarjen në rreshta që ka origjinali dhe rreshtat i kemi pajsur me numër rendor.

1) Materiali numër 1 është i datës 28 tetor 1940.

Është një kartolinë postare e Tagliavini-t për Schirò-in.

Transkriptimi

Faqja e parë:

Numri i protokollit është 675; është i shkruar me dorë lart majtas.

Lart në mes të letrës është intestimi ku është plotësuar me dorë data:

Padova, 28/X/40 XVIII (1)

“Liviano” – Tel. 22 – 941 (2)

Teksti i letrës në italishte i shkruar me dorë:

Caro Schirò, (3)

La R. Legazione d'Italia a (4)

Bucarest m'informa che il plico conte- (5)

nente le fotografie di manoscritti antichi a (6)

<i>me destinati è stato mandato a Roma,</i>	(7)
<i>(Min. Esteri) solo col corriere che è</i>	(8)
<i>partito di là il 24 ottobre e che deve</i>	(9)
<i>essere giunto ieri l'altro. Vi sarei</i>	(10)
<i>grato se ora, con questo dato positivo,</i>	(11)
<i>poteste fare la ricerca agli Esteri e farVi</i>	(12)
<i>consegnare il detto pacco, che potrete</i>	(13)
<i>mettere in luogo sicuro al "Centro"</i>	(14)
<i>in modo che io stesso lo possa prele-</i>	(15)
<i>vare quando verrò a Roma ai primi</i>	(16)
<i>di novembre per la seduta del Centro.</i>	(17)
<i>Appena poi avrete in mano il pacco</i>	(18)
<i>a me diretto mi farete cosa grata</i>	(19)
<i>scrivendomi una cartolina per mia</i>	(20)
<i>tranquillità.</i>	(21)

Faqja e dytë:

Lart majtas është stema që përmban dhe shkrimin:

R. UNIVERSITÀ DI PADOVA

Dhe poshtë saj:

ISTITUTO DI GLOTTOLOGIA

Vazhdon teksti i kartolinës:

Con molti cordiali (1)

saluti. (2)

Vostro (3)

Tagliavini (4)

Scrivetemi sempre a Bo- (5)

logna! (6)

Në mes të faqes është vula e postës, e rumbullakët. Në rreth ka të shkruar:

PADOVA CENTRO

Vijojnë tri rreshta me numra:

22-25 (1)

28 – X (2)

40 XIX (3)

Në cep lart djathtas është pulla e postës në formë drejtkëndëshi, me vlerë "Cent 30" dhe sipër ka një vulë në formë drejtkëndëshi.

Në vijim është adresa e marrësit:

Ill.mo (1)

Prof. Giovanni Schirò (2)

Ndihmesa e Carlo Tagliavini-t, Francesco Ercole-s dhe Giuseppe...

Centro di Studi Albanesi (3)
R. Accademia d'Italia (4)
Via della Lungara (5)
(ex Lincei) (6)
ROMA (7)

Përkthimi:
Padova, 28.X.40 XVIII
"Liviano" – Tel 22-941

I dashur Schirò,

Legata e Italisë në Bukuresht më informon se pakoja që ka fotografitë e dorëshkrimeve antike që janë për mua është dërguar në Romë, (Min. e Jashtme) vetëm me korrierin që është nisur që atje në datën 24 tetor dhe që duhet të ketë arritur pardje. Do t'jua dija për nder nëse tani, duke e ditur këtë gjë, do të mund të bënit kërkimin në Ministrinë e Jashtme dhe të merrni pakon në fjalë që do të mund ta vinit në një vend të sigurt tek "Qendra" në mënyrë që unë vetë të mund ta marr kur do të vij në Romë në ditët e para të nëntorit për mbledhjen e Qendrës. Pastaj, sapo ta keni në dorë pakon që më drejtohet mua, do të më bënit një nder duke më shkruar një kartolinë që unë të rri i qetë.

[Në kapakun e kartolinës majtas është stema dhe koka]
R. Università di Padova
Istituto di Glottologia

[Vazhdon letra, me përshëndetjet]

Përshëndetje të përzemërta
Juaji Tagliavini
Shkruamëni gjithmonë në Bologna.

[Në mes vula e postës është:]
Padova Centro

[Me numrat:]
22-23
28-X-40-XIX

[Marrësi, emri, i gabuar, mbiemri, dhe adresa:]

I nderuar
Prof. Giovanni [sic!] Schirò
Centro di Studi Albanesi
R. Accademia d'Italia
Via della Lungara
(Ex Lincei)
Roma

2) Materiali numër 2 është i datës 5 shtator 1941.

Është një kartolinë postare e shkruar me dorë nga Tagliavini për Schirò-in e datës 5.IX.1941.

Transkriptimi

Faqe 1:

Lart djathtas është shkruar data:

Bologna 5.IX.'41 XIX (1)

Vijon teksti i letrës.

<i>Caro Schirò,</i>	(2)
<i>la settimana scorsa sono</i>	(3)
<i>sono stato al Centro e non vi ho</i>	(4)
<i>trovato: ho lasciato sul vostro tavolo</i>	(5)
<i>la rassegna linguistica II: spero che</i>	(6)
<i>non si sia smarrita e vi sarei grato</i>	(7)
<i>di un cenno di conferma.</i>	(8)
<i>Sono passato anche da Bardi</i>	(9)
<i>per vedere se c'erano difficoltà nel</i>	(10)
<i>mio lavoro: il direttore mi disse che</i>	(11)
<i>mancavano solo 4 lettere bulgare nei</i>	(12)
<i>caratteri delle note, ma che le avrebbe</i>	(13)
<i>fatte fare: mi disse anche che la setti-</i>	(14)
<i>mana prossima (cioè questa che ora</i>	(15)
<i>sta per finire) avrebbe avuto pronte</i>	(16)
<i>le bozze: dissi naturalmente che</i>	(17)
<i>le mandasse a Voi, che poi avreste</i>	(18)
<i>pensato a mandarle a me. Dimenti-</i>	(19)
<i>cai però di avvertire che desidererei</i>	(20)

Ndihmesa e Carlo Tagliavini-t, Francesco Ercole-s dhe Giuseppe...

avere le bozze di quel lavoro in (21)

duplice copia; vedete di fare ancora (22)

Faqe 2:

Lart majtas është stema e universitetit të Padova-s, që poshtë në formë gjysmë harku ka të shkruar

R. UNIVERSITÀ DI PADOVA (1)

Vijon e shkruar drejt me shkronja të mëdha shtypi

SEMINARIO DI FILOLOGIA BALCANICA (2)

Vijon teksti i letrës i shkruar me dorë

in tempo e dare un colpo (3)

di telefono e appena avrete (4)

le bozze mandatemele perché (5)

la correzione sarà lunga e (6)

laboriosa. (7)

Cordiali saluti (8)

Tagliavini (9)

Lart në mes të faqes është vula e rumbullakët e postës ku lexohet qartë midis dy rathëve të jashtëm të vulës:

BOLOGNA FERROVIA.

Në mes të rrethit të vogël të vulës, në mes të vulës ka tre rreshta me numra, ku mezi lexohet vetëm rreshti i dytë:

5 - IX

Kurse rreshti i tretë (ku ndodhet numri i vitit) është pothuajse i palexueshëm:

XIX

Në të djathtë të faqes kemi pullën me vlerë Cent 30, në formë drejtkëndëshi dhe një vulë në formë drejtkëndëshi.

Vijon adresa e marrësit:

Illustrissimo (1)

Prof. Giuseppe Schirò (2)

Centro Studi Albania (3)

R. Accademia d'Italia (4)

Roma (5)

Via della Lungara (6)

Palazzo Acc. Lincei (7)

Përkthimi:

Bolonjë, 5.IX.1941 XIX

I dashur Schirò

javën e kaluar qeshë në Romë dhe fola me Çabejin; qeshë tek Qendra dhe nuk ju gjeta: lashë mbi tryezën tuaj pasqyrën e shtypit II; shpresoj që të mos ketë humbur dhe do t'ju lutesha që të më bënit të ditur që e morët.

Kalova edhe tek Bardi për të parë nëse kishte vështirësi në punimin tim: drejtori më tha se mungonin vetëm 4 shkronja bullgare në tekstin e shënimeve, më tha edhe se do të ngarkonte dikë që ta bënte këtë gjë; më tha edhe se javën e ardhshme (pra në këtë javë që po mbaron tani) do t'i kishte bocat gati: natyrisht i thashë që t'jua dërgonte juve, dhe se pastaj ju do të m'i dërgoni mua. Por harrova ta lajmëroj se do të dëshiroja që t'i kisha bocat e atij punimi në dy kopje; shikoni pak nëse mund ta lajmëroni në kohë.

[Në kopertinën e kartolinës së letrës së datës 5 shtator të Tagliavini-t për Schirò-in]

[Në pjesën majtas është stema dhe koka:]

R. Università di Padova

Seminario di Filologia Balcanica

[Në mes është vula e postës:]

Bologna Ferrovia

[Data në pjesën e mesme të vulës mezi shikohet]

[Në pjesën djathtas është emri dhe adresa e marrësit:]

Illustrissimo

Prof. Giuseppe Schirò

Centro Studi Albania

R. Accademia d'Italia

Roma

Via della Lungara

Palazzo Accademia dei Lincei

[Në pjesën majtas është vazhdimi i letrës:]

në kohë bëjini një telefonatë dhe sapo të keni bocat m'i dërgoni sepse korrigjimi do të jetë i gjatë dhe do të ketë shumë punë.

Me nderime

Tagliavini

Shënim (e. ç.): Tagliavini i shkruan Schirò-it për pasqyrën gjuhësore “Linguistica II” të botuar në “Rivista d’Albania”, fascicolo III, settembre 1941, ff. 277-285, si edhe për punimin e tij “Le parlate albanesi di tipo Ghego-orientale (Dardania e Macedonia nord-occidentale)”.